



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 17.08.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 16.08.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **NP DINI PHARM** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RITENDER "Furnizim me Interferon beta 1a nga Lista Esenciale"** me numër prokurimi 206-23-7805-1-1-1, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik **NP DINI PHARM** e dt. 16.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit: **RITENDER "Furnizim me Interferon beta 1a nga Lista Esenciale"** me numër prokurimi 206-23-7805-1-1-1, kundër Njoftimit për Kontratë të datës 25.07.2023 të publikuar në platformën elektronike.
- 2. Mbeten në fuqi** kriteret e përcaktuara në NJK dhe DT;
- 3.** Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
- 4.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **NP DINI PHARM** me datë 16.08.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RITENDER "Furnizim me Interferon beta 1a nga Lista Esenciale"** me numër prokurimi 206-23-7805-1-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 17.08.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE:

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 Barazia në trajtim/ Jo diskriminimi
Neni 27 Dosja e Tenderit
Neni 52 Njoftimi i Kriterëve për dhënien e kontratës
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Pretendimi ankimor

Te nderuar,

Me datën 25.07.2023, Autoriteti Kontraktues / Ministria e Shëndetësisë, ka publikuar njoftimin për kontrate dhe dosjen e tejetit për aktivitetin e prokurimit, sipas titullit: **“Furnizim me Interferon beta 1a nga Lista Esenciale”** dhe numër te prokurimit: **206-23-7805-1-1-1**, per lotiet: **Lot 1 - Interferon beta 1a 22 mcg dhe Lot 2 - Interferon beta 1a 44 mcg.**

Me datën 22.08.2023, është planifikuar hapja e ofertave, ndërsa , operatori ekonomik, **NP DINI PHARM**, si pale e interesuar për procedurën e prokurimit, dhe sipas afatit ligjor te përcaktuar ne nenin 108/A, te LPP-s, i kundërshton dhe besojmë qe keni përcaktuar kërkesa ne kundërshtim me ligjin e prokurimit, Nr. 04/L-042, i plotësuar me ligjet tjera.

Pretendimet e kërkesës për ri shqyrtim, kane te bëjnë me, kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, pika 9.1 & 9.2 – Kapacitetit teknik dhe profesional pozicioni 1 është kërkuar:

“Operatori ekonomik duhet te dëshmoj se është i Autorizuar nga prodhuesi për pjesëmarrje në tender ose nga zyra përfaqësuese e prodhuesit. (Nuk pranohen autorizimet ne mes distributorëve)”.

Ndërsa ne demi dokumentare është kërkuar:

“Autorizimi nga prodhuesi për pjesëmarrje ne tender ose nga zyra përfaqësuese e prodhuesit. Autorizimi duhet te përmbaj te dhënat mbi prodhuesin adresa, nr. tel, email, web faqja etj, (për mundësi te verifikimit)”.

Kjo kërkesë paraqet shkelje te ligjit për Prokurim Publik ashtu siç potencohet me ninit 7, te LPP-s. **“Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi”**

1. *Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*
2. *Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.*
3. *Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledhë sasi të ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.*
4. *Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.*

Kërkesa: "Autorizim nga prodhuesi ose zyra përfaqësuese e prodhuesit", është kërkesë tipike favorizuese ndaj operatorit ekonomik të caktuar dhe si e tillë eliminon konkurrencën. Në treg të Republikës së Kosovës, janë të identifikuar kompanitë e autorizuar nga prodhues të caktuar, po ashtu edhe për këto produkte dihet saktë cili prodhues ka zyrë përfaqësuese në Kosovë dhe kush është i autorizuar i tyre.

Përveç kësaj "Autorizimi", nuk mund të aplikohet tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional siç ju e keni përcaktuar.

Nenin 69, i të LPP-se, par 2, pika 2.1 – 2.5, parashohin: listë të furnizimeve paraprake (si kërkesë baze por e pa aplikuar nga AK – MSH), padisje teknike, përfshirjen teknike, mostrat e produkteve dhe certifikimet e hartuara nga institucionet zyrtare publike për kontroll të cilësisë.

Kjo kërkesë, ka të bëjmë me nenin 66, të LPP-s, Përshtatshmëria Profesionale, ku paragrafi 2, përcakton:

- *"Nëse lëndë e aktivitetit të prokurimit është kontrata publike që përfshin ofrimin e shërbimeve profesionale, dhe nëse këto shërbime i takojnë llojit që normalisht mund të ofrohen vetëm nga operatori ekonomik që ka autorizimin ose licencën e autoritetit publik ose që është anëtar i organizatës së caktuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të ofrojnë dëshmi të arsyeshme se ata kanë autorizimin ose licencën e tillë..., Lënda e kontratës ka të bëjë me furnizim – kontratë publike komize dhe jo ofrim shërbimesh.*

Autoriteti i juaj Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë, ka kërkuar edhe licence nga AKPPM, si qarkullues me shumice, është kërkuar edhe **Autorizim për Marketing me dozën e produkteve**, tani kërkesa për autorizim nga prodhuesi, konkretisht nga zyra përfaqësuese e prodhuesit dhe mohimi i ofrimit të autorizimit nga distributori, shkele ligjin e prokurimit, shkel tregun dhe konkurrencën e lire dhe qon në kontrate një burimore por me procedure të hapur.

Prandaj operatori ekonomik "NP DINI PHARM – Prishtine, kërkon që AK – Ministria e Shëndetësisë, të nxjerri këtë:

V E N D I M

- **Ta aprovoni**, kërkesën për ri shqyrtim si e bazuar,
- **Te anulohet aktiviteti i prokurimit në tërësi**, si i kundërligjshëm dhe pas Ri tenderimit, të përcaktoni kërkesa konkrete dhe proporcionale me lenden që kërkon të prokuroni në atë mënyre që nuk e kufizon konkurrencën, konkretisht nuk favorizon vetëm një operator ekonomik.

Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues në lidhje me pretendimin Ankimore

AK nuk pajtohet me pretendimet e juaja në kërkesën tuaj për rishqyrtim të parashtruar për AP, duke marrë parasysh se kriteret e tenderit janë të njëjta sikur për të gjitha produktet farmaceutike që tenderohen, njëjtë edhe për këtë aktivitet AK-MSh ka përdorur kriteret e njëjta të tenderimit.

Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se është i Autorizuar nga prodhuesi për pjesëmarrje në tender ose nga zyra përfaqësuese e prodhuesit. (Nuk pranohen autorizimet në mes distributorëve).

Dëshmia 1. Autorizimi nga prodhuesi për pjesëmarrje në tender ose nga zyra përfaqësuese e prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhënat mbi prodhuesin adresë, nr. tel, email, web faqja etj, (për mundësi të verifikimit).

Ky kriter është i domosdoshëm, meqenëse garanton nderlidhjen në mes operatorit ekonomik me prodhuesin ose me zyra përfaqësuese të prodhuesit, si subjekt me të drejta dhe autorizime të bartura nga prodhuesi dhe në emër të prodhuesit.

Kërkesa se nuk pranohen autorizimet në mes distributorëve, është shumë e drejte dhe e rekomanduar nga njohësit e fushës, meqenëse distributori është i autorizuar për shitjen e produkteve dhe mundet vet të ofertojë në tender, e nuk është i autorizuar që të drejtën e vet ta bart tek një distributor tjetër.

Në Ministrinë e Shëndetësisë nga fillimi i vitit 2023 ekziston dokumenti PSO (Procedura Standarde Operative) për iniciimin e aktiviteteve për furnizim me barna nga lista esenciale, në të cilën ekspertet e lamisë i kanë parapare kushtet që duhet të plotësohen tek këto aktivitete të furnizimit me barna nga LE.

Kjo PSO bazohet ne legjislacionin – aktet si me poshtë:

- Ligji i Prokurimit Publik
- A01 Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik
- Ligji për Produkte dhe Pajisje Medicinale
- Udhëzimi administrativ (shëndetësi) Nr.01/2022 për thjeshtësimin e procedurave për regjistrimin dhe importin e produkteve medicinale që nuk kanë paralele të autorizuara në Republikën e Kosovës
- Rregulla Financiare 01/2013MF Shpenzimi i Parave Publike
- Ligji për Menaxhimin e Financave Publike

Sa i perket pretendimit rreth kategorizimit te kriterit ne mes kerkesave profesionale dhe teknike/profesionale, nenit 66 apo 69 te LPP-se, kjo nuk eshte relevante per ju si OE, por ne si AK-MSh duke marre parasysh se kjo kerkese nderlidhet me regjistrimin e produkteve AM dhe obligimet qe kane palet sipas Ligji për Produkte dhe Pajisje Medicinale, e kategorizojme ne kuader te **Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale (9.1 & 9.2).**

Ju si OE ankues duhet ta keni parasysh rëndësinë e këtyre produkteve për pacientet me Skleroze dhe faktin qe është mungese e tyre ne stokun e MSh-se, është shume me rëndësi te mos ketë vonese te procesit dhe rrezikim te trajtimit te pacienteve te kësaj kategorie, andaj çdo ankesë e pa bazuar, përveç aspektit procedural dhe ligjor, bart me vete një barre te madhe morale.


Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Vendimi i dorëzohet:

1. NP DINI PHARM
2. Operatoreve ekonomik te interesuar


Berat Marmullaku
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit